

VENDIM
Nr. 346, datë 24.4.2013

**PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË
TEKSTILEVE TË PAMBUKTA DHE OBJEKTEVE TË VJETRA TË ISH-UZINËS “DINAMO”
E RE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 14 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objektet e ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta dhe objektet e vjetra të ish-uzinës “Dinamo” e re, Tiranë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimin, në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këto objekte, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të bëjë kalimin në pronësi të këtyre objekteve për banorët e pastrehë, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha